

FORMULARI NUMËR 3
KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR

Emri:	IKRAMIJE
Mbiemri:	BOJAXHIU

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni si vijon:

I. Analizën tuaj:

1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?

Sipas një vlerësimi të përgjithshëm të gjendjes aktuale të prokurorisë së shtetit, përkundër të arriturave të shumta, sistemi prokurorial është përballur me një sërë sfidash dhe reforma ligjore të shpeshta. Një ndër çështjet që është evidentuar është ngarkesa e madhe me lëndë në nivel vendi, të cilën situatë e ka përkeqësuar mungesa e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, praktikat dhe procedurat e brendshme të punës shpesh të ndërlikuara që kanë ndikuar në krijimin e një sistemi të ballafaquar me vonesa në trajtimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme për luftimin e kriminalitetit, si dhe në cilësinë e shërbimeve që ofrohen për qytetarët.

Përballja me krimin e organizuar dhe korrupsionin, paraqet segment që duhet të trajtohet me kujdes, vendosmëri dhe të mbetet prioritet i lartë i sistemit prokurorial. Në këtë drejtim është e domosdoshme të avancohet cilësia e hetimeve dhe ndjekjes penale, dhe angazhim të palëkundur nga prokurorët e shtetit për zbatim rigoroz të ligjit në bashkëpunim të ngushtë me organet tjera të zbatimit të ligjit.

I përcjellë me ndryshime të shumta ligjore, me sisteme ndërkombëtare e vendore të administrimit që nga viti 2000, sistemi prokurorial e ka të vendosur segmentin e vendimmarrjes dhe politikbërjes në dy trupa të ndryshëm të cilëve u duhet më tepër koordinim dhe kualitet në vendimmarrje. Trupi i parë i administrimit, ai i Këshillit Prokurorial të Kosovës, është duke u përballuar me një sërë zhvillimesh të cilit i duhet mbështetje më e madhe për të siguruar resurset adekuate, ndërsa trupi i dytë, ai i Prokurorit të Shtetit, për të operuar me kapacitete të plota, i duhet angazhim më i madh në realizim të funksionit kushtetues e ligjor, përfshirë kapacitetet adekuate nga aspekti i integritetit të prokurorëve dhe stafit të saj. Të dy këta trupa përmes koordinimit dhe bashkëpunimit, mund t'i tejkalojnë sfidat dhe të garantojnë siguri juridike.

Aktualisht, ka kritika në punën e prokurorisë dhe nganjëherë me të drejtë, por avancimi i sistemit prokurorial mund të vihet në jetë vetëm me ngritjen e kapaciteteve njerëzore, duke filluar nga ato të udhëheqjes, shtimin e burimeve financiare dhe nevojën për mekanizma të avancuar që monitorojnë dhe vlerësojnë performancën e prokurorëve dhe stafit administrativ, për t'u siguruar që secili të

mbajë përgjegjësi për detyrat ligjore. Këto kapacitete do të mundësojnë politika adekuata, llogaridhënie më të plotë dhe rol proaktiv në mbrojtjen e të drejtave ligjore të të gjithëve pa dallim.

Nga perspektiva ime, vlerësoj se duhet të intensifikohet bashkëpunimi ndërinstitucional me institucionet gjegjëse vendore dhe ndërkombëtare në çështjet penale, nga e cila varet puna e prokurorit të shtetit në sigurimin e provave relevante për të përfunduar hetimet penale ndaj personave të dyshuar dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave të krimit, si obligim shtetëror. Kjo do t'i kontribuonte thellimit të bashkëpunimit dhe forcimit të sistemit prokurorial për zgjidhjen e çështjeve me interes të veçantë.

Po ashtu, vërehet tendenca për ndërhyrje nga akterët e jashtëm të cilët kritikojnë punën e prokurorit të shtetit, çështje që duhet trajtuar me kujdes dhe vendosmëri për të mbrojtur integritetin e institucionit dhe për të rritur besimin e publikut, ngase ruajtja e pavarësisë së prokurorisë është jetike për funksionimin e drejtë të saj, dhe çdo ndërhyrje nga jashtë mund të dëmtojë ndjeshëm besueshmërinë. Nga ana tjetër, kritikakonstruktive dhe të arsyeshme për sistemin prokurorial duhet të merren në konsideratë, në atë mënyrë që të diskutohen, adresohen dhe të njëjtat t'i shërbejnë sistemit për të përmirësuar dhe avancuar profesionalizimin, performancën dhe transparencën.

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë për të cilën keni aplikuar?

Prokuroria e Apelit ka rol qendror jo vetëm në unifikimin e praktikave brenda Prokurorisë së Shtetit, por edhe përmes vendosjes lidhur me ankesat, të ushtrojë kontroll ndaj punës së prokurorëve. Rrjedhimisht, ky institucion ka funksion thelbësor për sigurimin e rishikimit të vendimeve të shkallës së parë dhe korrigjimin e gabimeve procedurale, substanciale dhe shkeljet tjera ligjore. Në këtë drejtim, korniza ligjore e krijon mundësinë që kjo prokurori të luaj rol të rëndësishëm në fuqizimin e Prokurorit të Shtetit.

Megjithatë, pozitiv është fakti se përkundër gjendjes aktuale, deri më tani, kjo prokurori ka arritur të kryej në kohë dhe brenda afateve ligjore të gjitha lëndët, duke u dalluar si prokurori që nuk ka lëndë të vjetra në proces. Puna ekipore në këtë prokurori është një mundësi e shkëlqyer që të shfrytëzohet për të avancuar rolin dhe profesionalizimin e Prokurorisë së Apelit.

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për herë të parë është paraparë mundësia ligjore që viktimat-të dëmtuarit të parashtrojnë ankesa kundër aktvendimeve të prokurorëve të shkallës së parë. Me këtë institut të ri, Prokurorisë së Apelit i janë shtuar kompetencat në procedurën penale, andaj, vlerësoj se duhet ngritur niveli dhe standardi i cilësisë dhe i profesionalizimit me rastin e trajtimit të ankesave të palëve të dëmtuara. Gjithsesi, vlerësoj se ky mekanizëm përveç që forcon statusin ligjor të të dëmtuarit, është një mekanizëm i duhur për t'a avancuar dhe përmirësuar sistemin prokurorial, ngase përmes vendimeve të marra

nga prokurorët e apelit lidhur me ankesat, Kryeprokurori do të ketë një pasqyrë më të qartë për nivelin profesional të çdo prokurori dhe efektin e vendimeve në praktikë.

Vlerësoj, se bashkëpunimi me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë Speciale, me Prokuroritë Themelore dhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk është i mirë organizuar në adresimin e sfidave dhe bashkëpunimit, ndaj, synoj që nëpërmes takimeve të rregullta të ndikohet në ngritjen e profesionalizimit, llogaridhënies dhe marrjen e vendimeve cilësore nga të gjithë prokurorët e shtetit.

Marrëdhënia me publikun është një tjetër segment i cili nuk është në nivelin e duhur në Prokurorinë e Apelit, ndaj, promovimi i punës dhe aktiviteteve të cilat zhvillohen brenda institucionit duhet përmirësuar përmes publikimit në ueb-faqen zyrtare, si dhe rekrutimi i stafit për të mbajtur komunikimin të rregullt me mediat, për çështjet që janë me rëndësi për opinionin publik, duke ruajtur dhe mbrojtur konfidencialitetin e informacionit të plasuar.

3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?

Prokuroria e Apelit e Kosovës si institucion i shkallës së dytë, aktualisht ballafaqohet me sfida të ndryshme duke përfshirë aspektin logjistik, mungesën e prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit mbështetës, mungesa e zyrtarit për media dhe zyrtar të IT-së, hapësirës së pamjaftueshme, trajnimeve të specializuara për natyrën dhe llojin e punës që e karakterizon këtë prokurori, profilizimi i prokurorëve, pastaj ngarkesa e madhe me lëndë në raport me numrin e prokurorëve, sidomos për çështjet e komplikua që kërkojnë analizë të thelluar juridike dhe kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimeve. Po ashtu, presioni kohor dhe afatet e shkurta ligjore për shqyrtimin e ankesave të palëve, dhënien e propozimeve dhe marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e palëve të dëmtuara, dhe mungesa e një vizioni të qartë për të materializuar mandatin ligjor, janë disa nga mangësitë të cilat do të adresohen nga ana ime, dhe me përmirësimin e gjendjes, padyshim do të përmbushen pritjet publike karshi institucionit.

Mangësi tjetër e Prokurorisë së Apelit është mungesa e Departamentit Special, i cili në trajtim do të duhej të kishte lëndët e pranuar nga Prokuroria Speciale, që kërkojnë shqyrtim të mirëfilltë në shkallë të dytë për çështjet e natyrës delikate për vepra penale siç janë krimi i organizuar, korrupsioni, krimet e luftës etj.

Në vlerësimin tim, marrë parasysh se kemi ngecje sa i përket komunikimit ndërinstitucional, Prokuroria e Apelit duhet të promovojë dhe të krijoj hapësirë për komunikim ndërinstitucional adekuat, me qëllim të avancimit të punës së Prokurorit të Shtetit. Për t'u arritur ky synim, duhet të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet prokurorive në të gjitha regjionet dhe institucionet tjera relevante, ku mund të diskutoheshin mundësitë për avancim të punës së prokurorëve dhe lehtësim të praktikave të punës, shtuar këtu edhe bashkëpunimin në nivelin ndërkombëtar, në mënyrë që të merren modelet më të mira nga vendet respektive.

Përfundimisht, vetëm një institucion mirë i organizuar mund të garantoj një prokurori të pavarur, të paanshme dhe me integritet që gëzon besimin e publikut.

4. A mendoni se strategjitë aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?

Strategjitë aktuale të sistemit prokurorial përbëjnë një bazë dhe mundësi që Prokuroria e Apelit, pas një vlerësimi të detajuar të proceseve të punës, përcaktimit të një vizioni të qartë dhe ambicioz, të përcaktojë objektiva dhe zbatojë aktivitete që do të përmbushin në mënyrë profesionale dhe përmbajtjesore mandatin ligjor dhe të shërbejnë si një udhërrëfyes i rëndësishëm për të adresuar sfidat aktuale.

Në këtë drejtim, vlerësoj se Prokuroria e Apelit ka nevojë për qartësim të vizionit të saj dhe unë kam një vizion të qartë dhe të detajuar për rrugën përpara. Duke qenë se sistemi prokurorial është në proces të hartimit të planit të ri strategjik, konsideroj se strategjia përpos tjerash, duhet të orientohet në drejtim të këtyre fushave: a) Rritja e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike; b) Optimizimi i procesit të apelit, c) Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies, dhe d) Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional, me që integriteti dhe zbatimi i plotë i këtyre objektivave në veprimtarinë e përditshme të Prokurorisë së Apelit, do të ndihmojë në përballjen e sfidave ekzistuese dhe do të siguroj që kjo prokurori të funksionojë me nivelin më të lartë të profesionalizmit dhe pavarësisë.

II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni aplikuar?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?

Duke u bazuar në mandatin kushtetues i cili përcakton se prokurori i shtetit duhet të veprojë i paanshëm, i pavarur dhe i barabartë për të gjithë qytetarët pa dallim, do të punoj parreshtur që puna operative të jetë profesionale, efikase dhe efektive.

Vizioni im do të fokusohet në krijimin e një strukture efektive dhe moderne të operacioneve të institucionit. Kjo përfshin optimizimin e rrjedhës së punës për trajtimin e lëndëve, minimizimin e vonësive procedurale dhe përmirësimin e ndarjes së përgjegjësisë në mes të prokurorëve dhe stafit administrativ. Për të arritur këtë, do të promovoj një kulturë profesionale që fokusohet në rezultate të matshme dhe me përgjegjësi të qarta.

Vizioni gjithashtu përfshin forcimin e integritetit profesional përmes trajnimeve të rregullta për prokurorët dhe stafin administrativ, për t'i pasuruar me njohuri dhe aftësitë të nevojshme për të zgjidhur rastet të cilat trajtohen nga Prokuroria e Apelit,

ngase sigurimi i një mjedisi pune që mbështet zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe etik është thelbësor për rritjen e performancës së përgjithshme të institucionit. Tutje, efikasiteti i Prokurorisë së Apelit mund të përmirësohet përmes zbatimit të teknologjive të avancuara, si digjitalizimi i dosjeve dhe përdorimi i duhur i sistemit të menaxhimit të lëndëve. Kjo do të lehtësojë qasjen në informacion dhe do të sigurojë që të gjitha proceset të ndjekin rrjedhën e tyre pa ndërprerje.

Vizioni im për përmirësimin e punës do të jetë i bazuar në plan të qartë, i fokusuar në efikasitet dhe cilësi përmes menaxhimit të proceseve të cilat përfshijnë disa komponentë kryesorë që mund të ndërtohen mbi parimet e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës teknologjike.

2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?

Zbatimi me kompetencë i mandatit ligjor nga ana e Prokurorisë së Apelit me fokus në unifikimin e praktikave brenda Prokurorit të Shtetit, që përmes vendosjes lidhur me ankesat të ushtrohet kontroll ndaj punës së prokurorëve do të jetë pjesë e objektivave të mia si Kryeprokurore. Fuqizimi i sistemit të administrimit të prokurorisë, promovimi i barazisë brenda prokurorëve dhe stafit administrativ, përkrahja në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe fuqizimi i komunikimit dhe bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar, do të jetë fokus i objektivave të mia, si më poshtë:

Forcimi i sistemit të administrimit në Prokurorinë e Apelit

Në mënyrë që të ketë llogaridhënie adekuate, transparencë më të madhe, efikasitet dhe punë më kualitative në Prokurorinë e Apelit, është domosdoshmëri që të forcohen resurset administruese të prokurorisë. Në këtë kuptim duhet të rishikohet sistemi aktual i komunikimit në të gjitha nivelet e Prokurorisë së Apelit dhe të ndërtohen mekanizma të administrimit të cilët sigurojnë administrim efikas. Gjatë ushtrimit të detyrës do të rishikoj planet aktuale, dhe të përgatis një plan të detajuar, të qartë, dhe të realizueshëm për administrimin e brendshëm, gjë e cila kërkon:

- Plan vjetor të punës;
- Planin për menaxhimin e lëndëve;
- Kolegjiumet e rregullta me prokurorë;
- Takime të rregullta konsultative me prokurorë dhe stafin administrativ;
- Pjesëmarrje dhe përfaqësim më i shpeshtë i prokurorëve në seanca;
- Motivim dhe mbështetje për ngritjen profesionale;
- Rritje të nivelit të llogaridhënies të prokurorëve dhe stafit administrativ;
- Vlerësim të nevojave për prokurorë dhe staf administrativ proporcionalisht me ngarkesën me punë.

Rritja e efikasitetit dhe cilësisë në trajtimin e lëndëve

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës së PA-së, në aspektin e

organizimit të punëve të brendshme dhe shërbimeve të administratës do të angazhohem që:

- Pranim dhe shpërndarja e lëndëve pa vonesa dhe në mënyrë të drejtë;
- Angazhim për të siguruar aplikim efektiv të SMIL;
- Zbatimin e mekanizmave të kontrollit të kualitetit;
- Krijimin e një procesi të rishikimit të brendshëm për të vlerësuar cilësinë e parashtrësive të ankesave dhe për të identifikuar fushat e përmirësimit.

Forcimi i politikave gjinore dhe gjithëpërfshirëse

Forcimi i barazisë gjinore në Prokurorinë e Apelit është thelbësor për të siguruar që sistemi prokurorial të pasqyrojë diversitetin, drejtësinë dhe gjithë përfshirjen.

Objektivat e synuara për të avancuar në këtë fushë janë:

- Zbatimi i politikave që adresojnë paragjykimet gjinore dhe i japin përparësi përfshirjes sociale brenda procesit të punës në prokurori;
- Ndërgjegjësimi dhe promovimi i kapaciteteve midis prokurorëve dhe stafit administrativ për të njohur dhe trajtuar çështjet e lidhura me aspektet gjinore dhe të gjithë përfshirjes;
- Sigurimi i qasjes për grupet e cenueshme;

Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në Prokurorinë e Apelit

Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në proceset e punës është jetik për ndërtimin e besimit në sistemin prokurorial, sigurimin e proceseve të drejta dhe rritjen e besimit të publikut. Objektivat dhe veprimet specifike për të nxitur transparencën dhe llogaridhënien janë:

- Publikimi i rregullt i statistikave, raporteve analitike të performancës dhe trendeve për punën e Prokurorisë së Apelit;
- Vendosja e standardeve të qarta të llogaridhënies për prokurorët dhe stafin administrativ;
- Vlerësimi i performancës së prokurorëve;
- Inicimin e procedurave disiplinore në rast të shkeljeve eventuale nga prokurorët;
- Marrja e vendimeve për përjashtimin e prokurorëve në lëndët konkrete në rastet kur vihet në dyshim paanshmëria;
- Lehtësimi i qasjes së publikut në punën e Prokurorisë së Apelit;
- Rritja e komunikimit me publikun mbi proceset e punës.

Rritja e shkathtësive dhe njohurive profesionale të prokurorëve dhe stafit administrativ

Rritja e shkathtësive dhe njohurive profesionale është thelbësore për të siguruar trajtim efektiv dhe me cilësi të lartë të apelineve. Kjo mund të arrihet duke u

fokusuar në trajnime të specializuara, profilizim të prokurorëve, shkëmbimin e njohurive dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional, që do të arrihet përmes objektivave:

- Ndjekja e programeve trajnuese specifike në kuadër të Trajnimit të Vazhdueshëm;
- Rritja e njohurive për standardet ligjore ndërkombëtare dhe legjislacionin për të drejtat e njeriut, dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Hartimi dhe unifikimi i dokumenteve ligjore bazuar në parimet dhe standardet ndërkombëtare;
- Vlerësime të rregullta dhe komente për përmirësime të vazhdueshme.

Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë mund të rris ndjeshëm efikasitetin e trajtimit të rasteve, të zvogëlojë vonesat dhe të përmirësojë rezultatet e punës. Kjo kërkon ndërtimin e kanaleve të forta të komunikimit, procedurave të standardizuara dhe objektiva të përbashkëta ndërmjet akterëve kryesorë, si prokuroria, gjyqësori, dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, nëpërmes:

- Takimeve të rregullta koordinuese me ZKPSH-në, KPK-në, Kryeprokurorët e të gjitha PTH-ve dhe PS, Gjykatën e Apelit, partnerët ndërkombëtar etj.;
- Zhvillimin e programeve të përbashkëta të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare;
- Promovimi i shkëmbimit të informacionit dhe integritetit të të dhënave.

3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përmbushjes së këtyre objektivave?

Gjatë realizimit të objektivave të përcaktuara pres që të has në sfida të ndryshme disa nga të cilat do t'i rendis si në vijim:

- Zbatimi i reformës në drejtësi sipas ndryshimeve ligjore eventuale;
- Ndryshimin e legjislacionit penal me efekt në politikën e miratuar më parë;
- Adresimi i kërkesave buxhetore sipas nevojave të Prokurorisë së Apelit;
- Zbatimi i proceseve të rekrutimit të prokurorëve dhe stafit për të plotësuar numrin e nevojshëm;
- Ngarkesat e larta të punës dhe burimet e kufizuara;
- Fuqizimi i integritetit të prokurorëve dhe stafit;
- Zbatimi i Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve-SMIL;
- Ngritja e cilësisë dhe kualitetit të vendimeve të prokurorëve;
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e prokurorëve dhe stafit;
- Profilizimi dhe specializimi i prokurorëve për fusha specifike;
- Ngritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit me institucione të zbatimit të ligjit;

4. Si do t'i tejkalonit ato?

Sfidat e theksuara me sipër do të tejkalohen vetëm me një lidërsnip të fortë dhe përkushtim ekipor, planifikim adekuat, resurse të mjaftueshme, bashkëpunim me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtar sidomos atyre që ofrojnë ekspertizë dhe projekte përmbajtësore, që janë çelës i shumicës së zgjidhjeve për tejkalim të sfidave dhe ofrojnë zgjidhje për objektivat e synuara, ashtu që nën menaxhimin tim do të demonstroj rol proaktiv në proceset e reformave në drejtësi.

III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

Ju lutem renditni hapat konkret që do t'i ndërmerrnit gjatë mandatit tuaj:

1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?

Sa i përket menaxhimit të stafit do të angazhohem në mënyrë aktive që Prokuroria e Apelit të ketë administratë të reformuar, e cila do të jetë strukturore, organizative dhe përmbajtësore, me synim që me zbatimin e detyrave të punës të përmbushen objektivat dhe qëllimet e përcaktuara. Për ta realizuar këtë reformë do të punoj me ekipe të ekspertëve të fushës për të identifikuar sistemin më të përshtatshëm të administratës.

Krahas reformës, do të promovohet sistemi i rekrutimit, avancimit dhe vlerësimit në bazë të meritokracisë, ndërsa disiplina dhe kualiteti i punës do të jenë faktorët kyç për pozitën e stafit administrativ në prokurori. Modeli im do të drejtohet edhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve dhe ndërtimi i sistemit të karrierës, prioritizimit të rasteve, vlerësimit objektiv i bazuar në rezultatet e punës, që stafi të ketë mundësi të avancojë në karrierë dhe të ndjehet i motivuar për të kontribuar në suksesin e përgjithshëm të institucionit.

2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?

Së bashku me administratën qendrore në Këshillin Prokurorial të Kosovës, do të hartojmë analizat përkatëse për modelin e organizimit të stafit të Prokurorisë së Apelit. Do të kem qasje gjithëpërfshirëse duke marrë për bazë aftësitë dhe kapacitetet e secilit në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiive në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe të balancuar të punës me qëllim të arritjes së objektivave. Rëndësi të veçantë do ti kushtohet Rregullores për Ndarjen e Lëndëve, ashtu që ndarja të bëhet vetëm përmes sistemit elektronik SMIL, në mënyrë që në të ardhmen të shkohet vetëm drejt ndarjes automatike.

3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhënien dhe profesionalizmin e stafit?

Krijimi i një sistemi unik të raportimit dhe mbikëqyrjes permanente, vlerësimi i performancës bazuar në kritere të qarta, objektive dhe të matshme, do të jenë pikënisje për të përmirësuar llogaridhënien e stafit. Trajnime të vazhdueshëm, ndër të tjera trajnim për menaxhimin e stresit, dhe udhëzimet adekuate të bazuara në nevoja

konkrete janë rruga e cila do të ndiqet për të ngritur profesionalizmin dhe llogaridhënien në punë, ashtu që proceset e punës të menaxhohen përmes sistemeve elektronike inovative dhe data bazave të përshtatshme. Për më tepër, do të promovohet mënyra proaktive dhe ekipore e punës, përfshirë publikimin e punës dhe rezultateve për stafin administrativ, ndërsa do të reagojë gjithmonë ndaj shkeljeve eventuale disiplinore dhe do të rekomandohen masa ligjore adekuate tek administratori i prokurorisë.

IV. Hapat që do të ndërmerri për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënies së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?

Ju lutem listoni/përmendni veprimet tuaja afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata:

1. Çfarë hapash do të ndërmerri për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?

Respektimi i plotë i Kodit të Etikës do të jetë një hap i parë thelbësor duke përcaktuar qartë standardet e sjelljes profesionale dhe të përgjegjësisë për prokurorët dhe stafin. Kodi duhet të zbatohet në mënyrë rigorozë dhe të mbështetet nga mekanizma të brendshëm që zbulojnë dhe ndalojnë veprimet që përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës.

Besimi i publikut në Prokurorinë e Shtetit ka qenë një çështje kritike për një kohë të gjatë, ndaj, përmirësimi i integritetit dhe llogaridhënies është themeli për rikthimin e besimit. Në këtë drejtim do të përqëndrohem në zhvillimin e mekanizmave të brendshëm që promovojnë etikën dhe sjelljen profesionale të prokurorëve, stafit dhe monitorimin e integritetit brenda prokurorisë.

Për të rritur besimin e publikut në institucion është e rëndësishme që Prokuroria të komunikojë në mënyrë të rregullt dhe transparente me qytetarët, ndaj, hapi i dytë do të jetë komunikimi dhe publikimi i raporteve periodike mbi rezultatet e punës dhe aktivitetet e saj dhe krijimi i një platforme ku qytetarët mund të paraqesin ankesat e tyre, duke u siguruar që qytetarët të jenë të informuar mbi progresin e rasteve me interes të lartë publik, dhe në anën tjetër do të siguroj menaxhim të kujdesshëm për të mbrojtur konfidencialitetin dhe të dhënat e ndjeshme. Kjo do të ofrojë transparencë për publikun, dhe do të ndikojë në forcimin jo vetëm të besimit të publikut në institucion, por edhe do të motivojë prokurorët që të ngritin performancën.

Hapi i tretë ka të bëjë me rishikimin akteve të brendshme ligjore për përmirësimin e kualitetit të punës si dhe intensifikimi i mbikëqyrjes për zbatimin, me qëllim të vendosjes së drejtë e meritore të rasteve penale, respektimin e konfidencialitetit të procedurës, mbrojtjen e të drejtave dhe liritë e njeriut, të cilat si rezultat do të ngritin besimin e publikut. Nëse më jepet besimi që të menaxhoj me këtë prokurori, do të punoj në ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit për të qenë më transparent dhe të kenë integritet si bartës të këtyre funksioneve, do të bëj të mundur hartimin e

politikave për të ngritur besimin e publikut, ndërsa transparencja dhe llogaridhënia do të jenë gjithmonë në nivelin e standardeve më të larta të respektimit.

Përfundimisht, do të vendos një balancë në mes transparencës dhe konfidencialitetit, duke u siguruar që qytetarët të kenë besim në vendimet që merren në Prokurorinë e Apelit, dhe në anën tjetër në mbrojtjen e integritetit të institucionit.

2. Cilat janë planet tuaja për të siguruar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?

Në Prokurorinë e Apelit do të krijohen kushtet e nevojshme dhe të barabarta për të gjithë prokurorët dhe stafin mbështetës për përforcimin e nivelit profesional, duke ofruar secilit mundësitë për pjesëmarrje në trajnime dhe aktivitete promovuese, që ndikojnë në cilësinë e punës dhe ngritjen e kapaciteteve, me qëllim të trajtimit efikas të çështjeve penale dhe të natyrës administrative.

Planet e mia mbështeten në objektivat e sipërshënuara, me fokus në kryerjen e lëndëve me efikasitet dhe përkushtim maksimal, por pa u cenuar niveli profesional në vendimmarrje. Bazuar në këtë, në konsultim me KPK, ZKPSH, dhe në bashkëpunim me kolegët prokurorë do të planifikoj politika dhe ndërmarr masa për rritjen e cilësisë së zbatimit të procedurave dhe detyrave përkatëse, me qëllim që aktet juridike të jenë profesionale, mirë të arsyetuara dhe të mbështetura në ligj.

3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënies së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?

Në kuadër të planeve të mia, do të angazhohem për arritjen e objektivave të sipërshënuara në rritjen e llogaridhënies duke u fokusuar në krijim të kushteve adekuate për punë, prokurorë e personel të mjaftueshëm, takime konsultative me prokurorët dhe stafin dhe mbikëqyrje e vazhdueshme në drejtim të respektimit të përpiktë të domenit të punëve të secilit të punësuar dhe promovimit të saj, përdorim të sistemeve digjitale në punë, takime me partnerët ndërkombëtar, shoqërinë civile, mediat dhe akterë tjerë relevant, si dhe në dy aspekte kryesore që janë disiplinimi dhe performanca, me synimin për të ndërtuar një prokurori të pavarur dhe të paanshme. Po ashtu, mbikëqyrja në respektimin e rregullave të sjelljes nga Kodit i Etikës, do të jenë prioritet i lartë për të parandaluar çdo ndërhyrje të jashtme apo të brendshme që mund të dëmtojë integritetin dhe besimin e publikut.

Deklaroj se përmbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam në dijeni se i njëjti do të publikohet në uebportal.

Nënshkrimi: 

Datë: 08.11.2024